



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

RREGULLORE

PËR
ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITET DHE ORGANET DREJTUESE NË
UNIKO

(Miratuar me Vendimin nr. 121, datë 21.03.2024, të Senatit Akademik të UNIKO)

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof.dr. Dhimitri Bello



TABELA E PËRMBAJTJES

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	5
NENI 1.....	5
OBJEKTI	5
NENI 2.....	5
BAZA LIGJORE.....	5
NENI 3.....	5
SUBJEKTET E RREGULLORES	5
NENI 4.....	6
PARIME TË PËRGJITHSHME	6
NENI 5	8
PERIUDHA ZGJEDHORE DHE THIRRJA E ZGJEDHJEVE.....	8
KREU II.....	8
STRUKTURAT PËR PËRGATITJEN DHE ADMINISTRIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE NË UNIKO.....	8
NENI 6.....	8
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE (KIZ).....	8
NENI 7.....	10
KOMISIONET E ZGJEDHJEVE NË FAKULTETE.....	10
NENI 8.....	11
QENDRAT E VOTIMIT	11
NENI 9.....	12
KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT (KQV).....	12
NENI 10.....	12
TË DREJTAT DHE DETYRAT E VËZHguesVE	12
KREU III	13
ZGJEDHËSIT DHE LISTA E ZGJEDHËSVE	13
NENI 11	13
ZGJEDHËSIT DHE PËRGATITJA E LISTËS SË ZGJEDHËSVE	13
NENI 12.....	15
TRUPA ZGJEDHORE PËR ANËTARË TË SENATIT NGA PERSONELI AKADEMIK.....	15
NENI 13.....	15
TRUPA ZGJEDHORE PËR ANËTARË TË SENATIT AKADEMIK NGA STUDENTË.....	15
NENI 14.....	15
TRUPA ZGJEDHORE PËR REKTORIN	15
NENI 15.....	15
TRUPA ZGJEDHORE PËR DREJTUESIN E NJËSISË KRYESORE	15
NENI 16.....	16
TRUPA ZGJEDHORE PËR DREJTUESIN E NJËSISË BAZË.....	16
NENI 17.....	16

TRUPA ZGJEDHORE PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME	16
KREU IV	16
REGJISTRIMI I KANDIDATËVE DHE FUSHATA ZGJEDHORE	16
NENI 18	16
REGJISTRIMI I KANDIDATËVE	16
NENI 19	16
KRITERET PËR ANËTARËT E SENATIT AKADEMIK.....	16
NENI 20.....	17
KRITERET PËR REKTOR TË UNIKO	17
NENI 21	18
KRITERET PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE NË UNIKO	18
NENI 22	18
KRITERET PËR DREJTUES TË NJËSISË BAZË NË UNIKO	18
NENI 23.....	19
KRITERET PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË UNIKO.....	19
NENI 24.....	19
KANDIDIMI	19
NENI 25.....	20
PËRJASHTIMI NGA KANDIDIMI.....	20
NENI 26.....	20
DOKUMENTACIONI PËR KANDIDIM	20
NENI 27	21
KOHËZGJATJA E MANDATEVE	21
NENI 28.....	21
PËRFAQËSIMI I NJËSIVE KRYESORE NË SENATIN AKADEMIK.....	21
NENI 29.....	21
FUSHATA ZGJEDHORE NË UNIKO	21
KREU V	22
PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS DHE E DOKUMENTACIONIT PËR ZGJEDHJET	
.....	22
NENI 30	22
VENDNDODIJA E KOMISIONEVE ZGJEDHORE DHE E VENDEVE TË NUMËRIMIT	
TË VOTAVE.....	22
NENI 31	22
KOMISIONET PËR VLERËSIMIN DHE NUMËRIMIN E VOTAVE.....	22
NENI 32.....	22
PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR.....	22
NENI 33.....	23
DËRGIMI I MATERIALIJEVE ZGJEDHORE NGA KIZ NË KZF.....	23
KREU VI	24
VOTIMI	24
NENI 34.....	24

VEPRIMET PARAPRAKE PËR HAPJEN E QENDRËS SË VOTIMIT.....	24
NENI 35.....	25
PROCEDURAT E VOTIMIT.....	25
NENI 36.....	26
MBYLLJA E VOTIMIT.....	26
NENI 37.....	27
VEPRIMET PAS MBYLLJES SË QENDRËS SË VOTIMIT.....	27
NENI 38.....	28
PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË FLETËVE TË VOTIMIT.....	28
NENI 39.....	28
ANKIMIMET.....	28
NENI 40.....	30
ANKIMI NE KOMISIONIN E APELIMIT.....	30
NENI 41.....	31
PAVLEFSHMËRIA E ZGJEDHJEVE.....	31
NENI 42.....	31

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat për përgatitjen, organizimin, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, vëzhgimin, fushatën elektorale dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UNIKO, duke përfshirë:

- a. Kushtet dhe afatet për regjistrimin e kandidatëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre, dokumentacionin zgjedhor, listat e zgjedhësve, fushatat zgjedhore;
- b. Vlerësimin e ligjshmërisë së promovimit akademik;
- c. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e administratës zgjedhore;
- d. Kriteret për hartimin e listës së zgjedhësve;
- e. Procedurat për votimin, vlerësimin dhe numërimin e votave, shpalljen e rezultateve;
- f. Procedurat për shqyrtimin e ankimimeve;
- g. Administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit zgjedhor;
- h. Kushtet dhe afatet për regjistrimin e vëzhguesve, të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; Ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligjin nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*"; Ligjin nr. 45/2015 "*Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*"; Ligjin nr. 9367, datë 7.4. 2005 "*Për parandalimin e konfliktit e interesave në ushtrimin e funksioneve publike*", i ndryshuar; Ligjin nr. 138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*"; në urdhrin e ministrit përgjegjës për arsimin për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë; si dhe në Statutin e UNIKO-së.

Neni 3

Subjektet e rregullores

1. Subjekt i kësaj rregulloreje janë të gjitha strukturat akademike të UNIKO së (njësitë kryesore dhe njësitë bazë) dhe studentët, të cilat i nënshtrohen procesit zgjedhor.
2. Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë, i njëjësive kryesore në UNIKO, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr.80/2015 "*Për arsimin*

e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e UNIKO-së dhe në këtë rregullore.

3. Anëtarët e personelit akademik, që sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, kanë mbushur moshën për pension, nuk kanë të drejtë të zgjidhen si autoritete drejtuese ose në organet drejtuese dhe nuk bëjnë pjesë në trupën zgjedhore.
4. Anëtarët e personelit akademik që, sipas nenit 63 të ligjit nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, shkëputen për një periudhë deri në 1 (një) vit për vitin sabatik nuk kanë të drejtë të zgjidhen si autoritete drejtuese ose anëtarë të organeve drejtuese, por gëzojnë të drejtën të zgjedhin autoritetet drejtuese ose organet drejtuese, nëse perioda e parashikuar më sipër përkon me periudhën zgjedhore.
5. Çdo student aktiv i ciklit të parë, ciklit të dytë dhe programeve profesionale 2-vjeçare në UNIKO, ka të drejtën e zgjedhjes së autoriteteve dhe organeve drejtuese (me përjashtim të drejtuesit të njësisë bazë). Çdo student aktiv ka të drejtën e zgjedhjes dhe të të zgjedhurit për përfaqësuesit e studentëve në organet drejtuese, në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë rregullore dhe në ligjin nr. 80/2015 *"Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, Statutin e UNIKO-së dhe në këtë rregullore.
6. Në zbatim të kësaj rregulloreje do të konsiderohet student aktiv çdo student, i cili përfshihet në regjistrat e frekuentimit të vitit akademik në të cilin zhvillohen zgjedhjet, si dhe është subjekt i pagesës së tarifës vjetore të shkollimit për atë vit akademik.

Neni 4

Parime të përgjithshme

1. Zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese në UNIKO janë periodike, çdo 4 vjet.
2. Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë rregullore.
3. Çdo zgjedhës ka të drejtën e 1 (një) vote të vetme për zgjedhjen e çdonjërit prej autoriteteve ose anëtarëve të organeve drejtuese.
4. Si mjet identifikimi për të votuar pranohet pasaporta ose letënjohësi (ID).
5. Të drejtën për t'u zgjedhur në postin e një autoriteti drejtues, (rektor dhe dekan), e kanë edhe persona që nuk bëjnë pjesë në stafin akademik me kohë të plotë në njësitë kryesore të UNIKO-së të cilët i plotësojnë kriteret e parashikuara në dispozitat ligjit nr.80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, në Statutin e UNIKO-së dhe në këtë rregullore, për të konkurruar për këtë post.
6. Të drejtën për t'u zgjedhur si autoritet drejtues i UNIKO-së, e ka çdo anëtar i personelit akademik që nuk ka fituar, në të njëjtin funksion dhe në të njëjtin institucion, dy mandate të njëpasnjëshme apo të ndara, të fituara sipas ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 *"Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim, të fituara me zgjedhje, pavarësisht kohëzgjatjes.
7. Në kuptim të nenit 131, pika 3 të ligjit 80/2015, *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, mandat i fituar konsiderohet çdo

- mandat që është fituar përmes një procesi zgjedhor, pavarësisht nga kohëzgjatja e tij.
8. Çdo kandidat nuk mund të konkurojë njëkohësisht për më shumë se një post autoriteti drejtues, apo si anëtar i organeve vendimarrëse kolegjiale.
 9. Çdo kandidat ka të drejtën të organizojë dhe zhvillojë aktivitete për paraqitjen e programit të tij, duke mos cënuar procesin mësimor.
 10. Shpallet i zgjedhur në pozicionin e një autoriteti drejtues kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim, me përjashtim të kandidatëve të vetëm.
 11. Kur kandidon një kandidat i vetëm, ai shpallet fitues me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) për qind plus 1 (një) të votave të vlefshme. Nëse kandidati nuk arrin të fitojë një numër të tillë votash, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas ditës së zgjedhjeve zhvillohet një raund i dytë.
 12. Kur asnjëri prej dy a më shumë kandidatëve në garë për pozicionin e një autoriteti drejtues nuk arrin të sigurojë shumicën e votave të vlefshme, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike pas zgjedhjeve zhvillohet një raund i dytë. Nëse edhe pas raundit të dytë, asnjëri nga kandidatët nuk arrin të sigurojë shumicën, zgjedhja për autoritet drejtues bëhet me short. Shorti organizohet dhe realizohet nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve.
 13. Në rast se për postin e një autoriteti drejtues nuk regjistrohet ose nuk fiton asnjë kandidat, zgjedhjet për këtë post zhvillohen, me udhëzime të ministrit përgjegjës për arsimin, jo më përpara se 6 muaj nga data e zgjedhjeve të shpallura. Zgjedhjet e përsëritura zhvillohen në përputhje me kërkesat ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" dhe me këtë rregullore. Gjatë periudhës kur nuk ka drejtues të zgjedhur, për caktimin e drejtuesit të njësisë veprohet sipas rregullit të përcaktuar në nenin 39, pika 9, pika 10 dhe neni 42, pika 9 të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*".
 14. Zgjedhje të përsëritura zhvillohen jo më vonë se një vit përpara përfundimit të periudhës 4- vjeçare pas zgjedhjeve të fundit.
 15. Në rastin kur për anëtarë të Senatit Akademik konkurrojnë më shumë kandidatë sesa numri i mandateve të caktuara për njësinë kryesore përkatëse, fitues shpallen kandidatët që fitojnë numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim. Për kandidatët që fitojnë numër të barabartë votash, zgjedhja për anëtar të Senatit Akademik bëhet me short. Shorti organizohet dhe realizohet nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, në prani të palëve të interesuara, përveç rastit kur palët janë dakordësuar midis tyre. Dakordësimi duhet të bëhet me marrëveshje me shkrim, e cila duhet të dorëzohet në Komisionin Institucional të Zgjedhjeve.
 16. Në rastin kur për anëtar të Senatit Akademik konkurrojnë më pak ose po aq kandidatë sa numri i mandateve të caktuara për njësinë kryesore përkatëse, procesi zgjedhor zhvillohet në formatin "Pro"- "Kuudëri" të fletës së votimit dhe fitues shpallet/i kandidat/i/ët që ka marrë jo më pak se 50 (pesëdhjetë) për qind plus 1 (një) të votave të vlefshme.
 17. Në rastin kur mbeten vende vakante për anëtarë në Senatit Akademik, për arsye se numri i kandidatëve është më i vogël se numri i mandateve, në njësinë kryesore përkatëse zhvillohet një raund i dytë zgjedhjesh, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve. Për këtë raund kanë të drejtë të regjistrohen kandidatë të tjerë që i plotësojnë kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", Statutin dhe kërkesat e kësaj rregulloreje. Afati i regjistrimit të kandidatëve në këtë rast është 5 (pesë) ditë kalendarike pas shpalljes së rezultatit përfundimtar.

18. Vëzhguesit e kandidatëve që vijnë nga personeli akademik duhet të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë në UNIKO. Vëzhguesit e kandidatëve që vijnë nga studentët duhet të jenë studentë me kohë të plotë të njësisë kryesore përkatëse.

Neni 5

Periudha zgjedhore dhe thirrja e zgjedhjeve

1. Zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe organet drejtuese në UNIKO zhvillohen në mënyrë periodike, çdo katër vjet. Procesi zgjedhor zhvillohet njëherësh për të gjitha njësitë përbërëse të UNIKO-së.
2. Dita e fillimit të procesit zgjedhor dhe dita e zgjedhjeve caktohet nga ministri përgjegjës për arsimin.
3. Autoriteti më i lartë drejtues në UNIKO, shpall ditën e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e përcaktuar nga ministri për zgjedhjen e autoriteteve dhe organeve drejtuese në institucionin që drejton.
4. Zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese në UNIKO zhvillohen brenda së njëjtës dite.
5. Zgjedhjet jashite radhe për autoritetet drejtuese thirren brenda 6 muajve pas pas përfundimit para kohe të mandatit të autoritetit përkatës, nëse pjesa e mbetur e mandatit është jo më pak se një vit.
6. Qendrat e votimit hapen në orën 08.00 dhe mbyllen në orën 15:00. Askush nuk mund të votojë pasi Komisioni Zgjedhor i Fakultetit (më tej KZF)/Komisioni i Qendrave të Votimit (më tej KQV) merr vendim për mbylljen e votimit. Nëse pas orës 15:00 KZF (KQV) vëren se ka ende votues në radhë, u mbledhen atyre mjetet e identifikimit dhe u mundësohet votimi.

KREU II

STRUKTURAT PËR PËRGATITJEN DHE ADMINISTRIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE NË UNIKO

Neni 6

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ)

1. Zgjedhja e anëtarëve të KIZ-it është detyrë dhe përgjegjësi e Senatit Akademik të UNIKO-së. Jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve, Senati Akademik zgjedh KIZ-in, në përputhje me dispozitat e mëposhtme:
 - a) Senati akademik zgjedh anëtarët e KIZ-it, me votim të fshehtë, me shumicën e thjeshtë të anëtarësisë së tij, nga lista e të vetëkandiduarve që regjistrohen në sekretarinë e Senatit. Përfaqësimi dhe numri i anëtarëve të KIZ-it, përcaktohet mbi bazën e numrit të njësisë kryesore të UNIKO-së. Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në UNIKO përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë (një përfaqësues nga çdo njësi kryesore dhe një përfaqësues të studentëve). Nga Senati Akademik, caktohet dhe sekretari i KIZ-it, i cili është anëtar pa të drejtë vote pranë këtij

komisioni. Sekretari përzgjidhet nga lista e të vetëkandiduarve nga personeli ndihmësakademik i UNIKO-së.

- b) Periudha e vetëkandidimit për anëtarë të KIZ-it zgjat jo më shumë se 3 (tre) ditë kalendarike nga njoftimi i Senatit Akademik.
- c) Në rastin e largimit të një anëtari nga ky komision, zëvendësimi i tij kryhet si në pikën 1 të këtij neni.
- d) KIZ-i konstituohet të nesërmen e ditës së votimit për zgjedhjen e anëtarëve të KIZ-it në Senatin Akademik.
- e) Anëtari i KIZ-it nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtues dhe/ose për anëtar në organet drejtuese, të çdo niveli.
- f) Rektori thërret mbledhjen e parë të KIZ-it. Në mbledhjen e parë të tij KIZ-i zgjedh, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të tij, Kryetarin. Rezultati i zgjedhjeve publikohet në të gjitha mjediset e institucionit.
- g) Gjatë periudhës zgjedhore, KIZ-i mblidhet sa herë është e nevojshme. Mbledhja thirret nga kryetari ose të paktën nga dy anëtarë. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve. Mbledhjet e KIZ-it janë të hapura për kandidatët, vëzhguesit e kandidatëve dhe përfaqësuesit e ministrisë përkatëse.
- h) KIZ-i i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij. Vendimet e KIZ-it publikohen në mjedisin e institucionit ku është e vendosur selia e tij, jo më vonë se 12 orë pas vendimmarrjes.

2. KIZ-i ka këto kompetenca:

- a) Nxjerr udhëzime për organizimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor në të gjitha njësitë e UNIKO-së.
- b) Drejton dhe kontrollon të gjithë procesin zgjedhor.
- c) Emëron anëtarët e Komisioneve të Zgjedhjeve të Fakulteteve, të vetëkandiduar në KIZ.
- d) Akrediton vëzhguesit sipas kërkesave të palëve të parshikuara në këtë rregullore.
- e) Vendos për numrin e qendrave të votimit për çdo njësi kryesore.
- f) Miraton vulën për KIZ-in, KZF-në dhe vulën për kryetarin e KZF-së, të cilat prodhohen dhe administrohen sipas kuadrit ligjor në fuqi.
- g) Regjistron kandidatët për rektor dhe për anëtarë të Senatit Akademik.
- h) Shpall rezultatin e zgjedhjeve për rektor dhe anëtarë të Senatit Akademik.
- i) Administron, gjykon dhe merr vendim për ankimet që regjistrohen prej kandidatëve.

3. Mandati i anëtarit të KIZ-it ndërpritet në rastet kur:

- a) Kryen veprimtari në favor të një kandidati;
- b) Vdes;
- c) Jep dorëheqjen nga detyra;
- d) Dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- e) Me veprimet dhe mosveprimet e tij cënon rëndë veprimtarinë e KIZ-it dhe procesin zgjedhor;
- f) Mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në tre mbledhje radhazë. Tërbajtimi i çështjes së ndërpjetjes së mandatit të një anëtari të KIZ-it, në këtë rast, bëhet vetëm me kërkesën e kryetarit dhe sekretarit. KIZ-i merr vendim mbi këtë kërkesë, jo më vonë se 1 orë pas depozitimit të saj. Vendimin për ndërprerjen e mandatit e merr KIZ-i kur për të votojnë "Pro" jo më pak se 2/3 e

anëtarëve të tij, përjashtuar anëtarin për të cilin votohet. Vendi i mbetur bosh plotësohet brenda 24 orëve prej Senatit Akademik.

4. Sekretari i KIZ-it përgatit materialet për çdo mbledhje të KIZ-it. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve dhe për çdo rast jep shpjegime për çështjet që i kërkohen. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset e vuloset nga sekretari. Sekretari i KIZ-it është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të KIZ-it.
5. Vendimet e KIZ-it firmosen prej të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje dhe vulosen me vulën e KIZ-it. Çdo anëtar i KIZ-it krahas nënshkrimit të tij, mund të deklarojë në vendim votën kundër.
6. Kandidatët për rektor kanë të drejtë të kenë përfaqësuesin e tyre pranë KIZ-it, si anëtar ex-officio, pa të drejtë vote, gjatë muajit zgjedhor.

Neni 7

Komisionet e Zgjedhjeve në Fakultete

1. Vendimi për ngritjen e Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete, merron nga KIZ-i, jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike nga dita e formimit të tij. KIZ-i zgjedh anëtarët e KZF-së, me votim të fshehtë, me shumicën e thjeshtë të anëtarësisë së tij, nga lista e kandidatëve që vetë-kandidohen në sekretarinë e KIZ-it.
2. Përfaqësimi dhe numri i anëtarëve të KZF-së përcaktohet mbi bazën e numrit të njërive bazë në njësinë kryesore përkatëse. Në çdo rast, ai duhet të jetë numër tek dhe jo më i vogël se 3 (tre) anëtarë, njëri prej të cilëve është përfaqësues i studentëve dhe të tjerët personel akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore. Nga KIZ-i caktohet dhe sekretari i KZF-së, i cili është anëtar pa të drejtë vote pranë këtij komisioni.
3. Anëtari i KZF-së nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtues dhe/ose për anëtar në organet drejtuese, të çdo niveli.
4. Mbledhja e parë e KZF-së zhvillohet një ditë pas vendimit të KIZ-it për ngritjen e tij. Në këtë mbledhje zgjidhet, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të KZF-së, Kryetari. Rezultati i zgjedhjeve publikohet në mjediset ku zhvillon aktivitetin akademik njësia kryesore përkatëse.
5. KZF-ja mbledhet sa herë është e nevojshme për mbarëvajtjen e procesit në njësinë kryesore përkatëse. Mbledhja thirret nga kryetari ose të paktën nga dy anëtarë. Mbledhja është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve. Në mbledhjet e KZF-së mund të jenë të pranishëm kandidatët ose vëzhguesit.
6. KZF-ja i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve të pranishëm të tij. Vendimet e KZF-së publikohen në mjedisin e njësisë kryesore ku është e vendosur selia e tij, jo më vonë se 12 orë pas marrjes së tyre.
7. KZF-ja ka këto kompetenca:
 - a. Përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në njësinë kryesore.
 - b. Kryen funksionet e Komisionit të Qendrës së Votimit në rastin kur në njësinë kryesore ka vetëm një qendër votimi.
 - c. Fmëron kryetarin dhe anëtarët e Komisioneve të Qendrës së Votimit, në rast kur, me vendim

- të KIZ-it, në njësinë kryesore votimi do të zhvillohet në më shumë se një qendër votimi.
- d. Regjistron kandidatët për dekan të njësisë kryesore dhe për përgjegjës të njësisë bazë.
 - e. Publikon listën e zgjedhësve në mjediset e njësisë kryesore, pas miratimit përfundimtar të saj.
 - f. Shpall rezultatin e zgjedhjeve për dekan të njësisë kryesore dhe për përgjegjës të njësisë bazë, i publikon dhe ia percjell KIZ-it.
 - g. Shpall rezultatin e votimit për rektorin dhe për anëtarët e Senatit Akademik, të cilin e dërgon në KIZ.
 - h. Merr vendim brenda kompetencave të veta mbi ankimet që regjistrohen prej kandidatëve.
8. Kandidatët për dekan dhe drejtues të njësisë bazë kanë të drejtë të kenë përfaqësuesin e tyre në KZF dhe KQV, si vëzhgues, të cilët akreditohen prej KIZ-it. Vëzhguesit duhet të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë.
 9. Mandati i anëtarit të KZF-së ndërpritet në rastet kur:
 - a. Kryen veprimtari në favor të një kandidati;
 - b. Vdes;
 - c. Jep dorëheqjen nga detyra;
 - d. Dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - e. Me veprimet dhe mosveprimet e tij cënon rëndë veprimtarinë e KZF-së dhe procesin zgjedhor;
 - f. Mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në tre mbledhje radhazi. Shqyrtimi i çështjes së ndërprerjes së mandatit të një anëtarit të KZF-së, në këtë rast, bëhet vetëm me kërkesën e kryetarit dhe të sekretarit të tij, të cilët e paraqesin atë tek KIZ-i. Vendimin për ndërprerjen e mandatit të anëtarit të KZF-së e merr KIZ-i, jo më vonë se 12 orë pas paraqitjes së kërkesës. Për të, duhet të votojnë "Pro" jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij. Vendi bosh plotësohet brenda 24 orëve prej KIZ-it.
 10. Sekretari përgatit materialet për çdo mbledhje të KZF-së. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve dhe për çdo rast jep shpjegime për çështjet që i kërkojnë. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset e vuloset nga sekretari. Sekretari është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të KZF-së.
 11. Vendimet e KZF-së firmosen prej gjithë anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe vulosen me vulën KZF-së.

Neni 8

Qendrat e votimit

Pranë çdo njësisë kryesore, caktohen Qendrat e Votimit nga KIZ-i. Si rregull, çdo qendër votimi ka deri në 1 000 (një mijë) zgjedhës, të të gjitha trupave zgjedhore, përfshirë studentët. Në rast se njësisë kryesore ka më shumë se 1 000 (një mijë) zgjedhës, KIZ-i mund të caktojë më shumë se një qendër votimi për atë njësi kryesore.

Neni 9

Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV)

1. Në rastin kur procesi i votimit do të zhvillohet vetëm në një qendër votimi në njësinë kryesore, detyrat e Komisionit të Qendrës së Votimit kryhen prej KZF-së. Kur KIZ-i ka vendosur ngritjen e më shumë se një qendre votimi në njësinë kryesore, KZF-ja ngre komisionet e qendrës së votimit (KQV).
2. KQV-ja përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë, njëri prej të cilëve është përfaqësues i studentëve. Anëtarët e KQV-së emërohen prej KZF-së në bazë të vetëkandidimeve.
3. Vendimi për formimin e KQV-së merret prej KZF-së jo më vonë se tre ditë para ditës së votimit. Në këtë vendim caktohet edhe kryetari i KQV-së. Njëri prej anëtarëve kryen detyrat e sekretarit të KQV-së.
4. Anëtari i KQV-së nuk mund të kandidojë për asnjë post drejtues ose anëtar në organet drejtuese.
5. Komisioni i Qendrës së Votimit ka për detyrë vetëm organizimin, zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të votimit ditën e zgjedhjeve. Në përfundim të këtij procesi, KQV-ja administron materialet zgjedhore sipas procedurës dhe rregullave të caktuara në këtë rregullore, dhe ia dorëzon atë KZF-së.

Neni 10

Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve

1. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, vëzhguesit kanë këto të drejta:
 - a) Të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor;
 - b) Të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë;
 - c) Të shohin (të këqyrin) dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor.
2. Vëzhguesit kanë këto detyra:
 - a) Të respektojnë kërkesat e kësaj rregulloreje dhe udhëzimet e KIZ-it për vëzhgimin e zgjedhjeve;
 - b) Të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat në qendrat e votimit ose në vende të tjera të ndaluara sipas kësaj rregulloreje;
 - c) Të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KIZ-i, si dhe me një dokument identifikimi të pranuar nga KIZ-i;
 - d) Të mos mbajnë shenja dalluese që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësve;
 - e) Të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit, të numërimit dhe administrimit të zgjedhjeve;
 - f) Të qëndrojnë në vendin e caktuar të vëzhguesve.

KREU III

ZGJEDHËSIT DHE LISTA E ZGJEDHËSVE

Neni 11
Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve

1. Në zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të UNIKO-së:
 - a) Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë i njësive kryesore në UNIKO ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" dhe në këtë rregullore.
 - b) Anëtarët e personelit akademik që, sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", kanë mbushur moshën për pension, nuk kanë të drejtë të zgjidhen si autoritete drejtuese ose në organet drejtuese dhe nuk bëjnë pjesë në trupën zgjedhore.
 - c) Anëtarët e personelit akademik që, sipas nenit 63 të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", shkeputen për një periudhë deri në 1 (një) vit për vitin sabatik nuk kanë të drejtë të zgjidhen si autoritete drejtuese ose në Senatin Akademik, por gëzojnë të drejtën të zgjedhin autoritetet drejtuese ose Senatin Akademik, nëse periudha e parashikuar më sipër përkon me periudhën zgjedhore.
 - d) Çdo student aktiv i ciklit të parë, të dytë dhe të programeve profesionale 2-vjeçare në UNIKO, ka të drejtën e zgjedhjes së autoriteteve drejtuese (me përjashtim të drejtuesit të njësisë bazë) dhe të anëtarëve të Senatit Akademik, përfaqësues të studentëve në të. Çdo student aktiv ka të drejtën e zgjedhjes dhe të të zgjedhurit për përfaqësuesit e studentëve në Senatin Akademik, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" dhe në këtë rregullore.
2. Lista e zgjedhësve, personeli akademik, hartohet për çdo njësi bazë, mbi bazën e të dhënave të personelit akademik, të punësuar me kohë të plotë, që administrohen nga njësia e burimeve njerëzore të UNIKO-së. Çdo zgjedhës identifikohet me përbërësit zgjedhorë:
 - a) Emri
 - b) Atësia
 - c) Mbiemri
 - d) Datëlindja
 - e) Gjinia
 - f) Njësia bazë ku është i punësuar.
3. Organi përgjegjës për hartimin e listës së zgjedhësve janë strukturat e burimeve njerëzore të UNIKO-së dhe njësive bazë, dhe për studentët, Sektori i studimeve dhe Sektori TIK. Çdo zgjedhës identifikohet me përbërësit zgjedhorë:
 - a) Emri
 - b) Atësia
 - c) Mbiemri
 - d) Datëlindja

- e) Gjinia
 - f) Programi mësimor që ndjek studentit.
4. Procedura për hartimin e listës së zgjedhësve, personeli akademik, është si më poshtë:
 - a) Lista paraprake e zgjedhësve për personelin akademik të njësisë bazë hartohet nga strukturat e burimeve njerëzore, brenda 20 (njëzet) ditëve nga shpallja e ditës së zgjedhjeve.
 - b) Lista paraprake dërgohet në njësinë bazë përkatëse, e cila brenda 24 orëve verifikon dhe miraton përbërjen e saj. Lista e miratuar nga përgjegjësi/i ngarkuari me detyrën e përgjegjësit, të njësisë bazë i dërgohet dekanit ose të ngarkuarit me detyrën e dekanit të njësisë kryesore, i cili e miraton dhe e shpall brenda jo më vonë se 2 (dy) ditëve. Lista e miratuar afishohet në mjediset e njësisë kryesore. Një kopje e listës i dërgohet KIZ-it.
 - c) Lista e miratuar duhet të jetë e firmosur në çdo faqe prej dekanit ose të ngarkuarit me detyrën e dekanit të njësisë dhe e vulosur me vulën e njësisë kryesore.
 5. Lista përfundimtare miratohet nga dekani i njësisë kryesore. Organ përgjegjës për hartimin e listës së zgjedhësve për studentet është Sektori i studimeve dhe Sektori TIK.
 6. Procedura për hartimin e listës së zgjedhësve për studentët është si më poshtë:
 - a) Lista paraprake e zgjedhësve për studentët e njësisë kryesore hartohet prej Sektorit të Studimeve dhe Sektorit TIK jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga shpallja e ditës së zgjedhjeve.
 - b) Lista paraprake afishohet në mjediset e njësisë kryesore.
 - c) Gjatë një periudhe deri në 7 (shtatë) ditë pas shpalljes së listës paraprake, Sektori i Studimeve dhe Sektori TIK pranon kërkesat për korrigjime.
 - d) Pas verifikimit të kërkesës Sektori i Studimeve dhe Sektori TIK realizon korrigjimin e kërkuar brenda 48 orësh.
 - e) Pas përfundimit të periudhës për korrigjimin e listës, Sektori i Studimeve dhe Sektori TIK harton listën përfundimtare e cila miratohet prej dekanit. Lista përfundimtare e zgjedhësve për studentët afishohet në mjediset e njësisë kryesore. Një kopje e listës i dërgohet KIZ-it në të njëjtën ditë të miratimit të saj.
 - f) Lista përfundimtare miratohet nga dekani i njësisë kryesore. Lista e miratuar duhet të jetë e firmosur në çdo faqe, prej dekanit të njësisë kryesore dhe e vulosur me vulën e njësisë kryesore.
 7. 10 (dhjetë) ditë përpara ditës së zgjedhjeve, lista përfundimtare e zgjedhësve për personelin akademik dhe për studentët nuk mund të korrigjohet për asnjë arsye. Pas kësaj periudhe, zgjedhësit që nuk e kanë emrin në listën e zgjedhësve ose kanë gabime në përbërësit zgjedhorë mund t'i drejtohet me kërkesë KIZ-it. Ata mund të votojnë vetëm në rastin kur, pas shqyrtimit të kërkesës së tyre, KIZ-i vendos me vendim pozitiv lidhur me kërkesën për të marrë pjesë në zgjedhje. Kërkesa të tilla, KIZ-i mund t'i shqyrtojë deri në 2 (dy) ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Zgjedhësi i pajisur me vendimin e KIZ-it mund të votojë vetëm me paraqitjen e tij në Komisionin e Qendrës së Votimit.
 8. E gjithë procedura për hartimin e listës së zgjedhësve për personelin akademik dhe studentët monitorohet prej KIZ-it. Për këtë qëllim, KIZ-i miraton një plan pune kalendar dhe cakton dy prej anëtarëve të tij për monitorimin e këtij procesi. Anëtarët përgjegjës raportojnë në mënyrë periodike në KIZ, për ecurinë e procedurave për hartimin e listës së zgjedhësve.

Trupa zgjedhore për anëtarë të Senatit Akademik nga personeli akademik

Trupa zgjedhore për Senatit Akademik të UNIKO-së përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore përkatëse. Personel akademik me kohë të plotë, do të konsiderohet personeli i përcaktuar në nenin 11 të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Trupa zgjedhore për anëtarët të Senatit Akademik nga studentët

Trupa zgjedhore për anëtarët studentë të Senatit Akademik të UNIKO-së përbëhet nga studentët aktivë të cilët ndjekin studimet me kohë të plotë të ciklit të parë, të dytë dhe të programeve profesionale 2-vjeçare në këtë institucion.

Neni 14

Trupa zgjedhore për rektorin

Trupa zgjedhore për rektorin e UNIKO-së përbëhet nga:

- a) Personeli akademik me kohë të plotë i të gjitha njësive kryesore. Personel akademik me kohë të plotë, do të konsiderohet personeli i përcaktuar në nenin 11 të kësaj rregulloreje;
- b) Studentët aktivë të përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje. Votat e studentëve në përzgjedhjen e rektorit llogariten në masën 10% (dhjetë për qind) të totalit të përgjithshëm të votave.

Neni 15

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë kryesore

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë kryesore të UNIKO-së përbëhet nga:

- a) Personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore. Personel akademik me kohë të plotë, do të konsiderohet personeli i përcaktuar në nenin 11 të kësaj rregulloreje.
- b) Studentët aktivë të përcaktuar në nenin 3 kësaj rregulloreje, në atë njësi kryesore. Votat e studentëve në përzgjedhjen e drejtuesit të njësisë kryesore llogariten në masën 10% (dhjetë për qind) të totalit të përgjithshëm të votave.

Neni 16

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë bazë

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë bazë të UNIKO-së përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë bazë. Personel akademik me kohë të plotë, do të konsiderohet personeli i përcaktuar në nenin 11 të kësaj rregulloreje.

Neni 17
Trupa zgjedhore për anëtarët e komisioneve të përhershme

Trupa zgjedhore për anëtarët e komisioneve të përhershme në UNIKO përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë. Personel akademik me kohë të plotë, do të konsiderohet personeli i përcaktuar në nenin 11 të kësaj rregulloreje.

KREU IV

REGJISTRIMI I KANDIDATËVE DHE FUSHATA ZGJEDHORE

Neni 18
Regjistrimi i kandidatëve

1. Procesi i regjistrimit të kandidatëve për autoritetet dhe organet drejtuese në UNIKO fillon ditën e shpalljes nga komisioni zgjedhor përkatës dhe përfundon në orën 16.00 të ditës së pestë kalendarike.
2. Mosregjistrimi i kandidatëve bëhet me vendim të arsyetuar nga KIZ-i. Vendimi për mosregjistrim të kandidatëve është i ankimeshëm pranë Komisionit të Apelimit.

Neni 19
Kriteret për anëtarët e Senatit Akademik

1. Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", në Statut dhe në këtë rregullore.
2. a) Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik, në UNIKO, nga personeli akademik, i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të kandidatëve me këtë titull dhe për efekt përfaqësimi, kategoria e tyre mund të zbresë, sipas përcaktimeve të bëra në Statutin e UNIKO-së.
b) Në Senatit Akademik të UNIKO-së bëjnë pjesë dhe studentë në masën dhjetë përqind të numrit të anëtarëve të Senatit.
c) Senati Akademik i UNIKO-së përbëhet nga 19 anëtarë, të ndarë sipas skemës në vijim:
 - Rektori i zgjedhur, i cili drejton Senatit Akademik sipas përcaktimeve të nenit 39, pika 4, të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.05.2015, "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë*";
 - Të gjithë fakultetet e UK-së janë të përfaqësuar në Senat nga dekani i zgjedhur dhe nga 3 përfaqësues të personelit mësimor-shkencor të secilit fakultet.
 - Dy përfaqësues të studentëve, të zgjedhur sipas përcaktimeve të nenit 37, pika 4, të ligjit nr.

80/2015, datë 22.05.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë".

- d) Nëse mandati i anëtari të Senatit Akademik peronel akademik përfundon para kohe, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje, i njësisë kryesore përkatëse, për nga numri i votave të grumbulluara, në zgjedhjet e fundit, deri në përfundim të mandatit të nisur. Nëse nuk ka kandidatë të mbetur në listë nga ajo njësi kryesore, zhvillohen përsëri zgjedhjet, siç parashikohet në këtë rregullore.
3. Kandidatët për anëtarë të Senatit Akademik duhet të kenë integritet të lartë akademik, veç të tjerash, edhe në kuptimin e rregullshmërisë së zbatimit të procedurave të përfitimit të gradave dhe titujve akademikë.
4. Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik në UNIKO, përfaqësues të studentëve, i përkasin kategorisë student të ciklit të parë, të dytë dhe të programeve profesionale 2-vjeçare. Kandidatët duhet të kenë mesataren e ponderuar mbi 8 (tetë) të provimeve të dhëna deri në momentin e kandidimit. Kandidatët duhet të jenë studentë aktivë, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
- Mandati i një studenti të zgjedhur në Senatit Akademik përfundon kur ai:
- përfundon studimet e ciklit të studimit që ai ndjek në momentin e zgjedhjes;
 - humbet statusin e studentit; ose
 - nuk është student aktiv.

Në këto raste ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje, për nga numri i votave të grumbulluara, në zgjedhjet e fundit, deri në përfundim të mandatit të nisur. Nëse nuk ka studentë të mbetur në listë, zhvillohen përsëri zgjedhjet, siç parashikohet në këtë rregullore.

Neni 20

Kriteret për rektor të UNIKO-së

- Kandidatët për rektor të UNIKO-së, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e UNIKO-së dhe në këtë rregullore.
- Kandidatët për rektor të UNIKO-së duhet të mbajnë titullin "Profesor" dhe mund të vijnë nga radhët e personelit akademik të UNIKO-së ose jashtë tij.
- Nuk mund të kandidojnë për rektor të UNIKO-së, kandidatët që:
 - Kanë qënë rektor të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme apo të ndara në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, përlllogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara me zgjedhje, pavarësisht kohëzgjatjes;
 - Kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
 - Kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese;
 - Janë në vit sabbatik në periudhën e kandidimeve.

Neni 21
Kriteret për drejtues të njësisë kryesore në UNIKO

1. Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore në UNIKO, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", në Statut dhe në këtë rregullore.
2. Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore në UNIKO i përkasin kategorisë "Profesor" dhe mund të vijnë nga radhët e personelit akademik të tij ose jashtë tij.
3. Nuk mund të kandidojnë për drejtues të njësisë kryesore në UNIKO, kandidatët që:
 - a) Kanë qenë drejtues të njësisë kryesore të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme apo të ndara, në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, përlogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara me zgjedhje, pavaresisht kohëzgjatjes;
 - b) Kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*";
 - c) Kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese;
 - d) Janë në vit sabbatik në periudhën e kandidimeve.

Neni 22
Kriteret për drejtues të njësisë bazë në UNIKO

1. Kandidatët për drejtues të njësisë bazë në UNIKO, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", në Statut dhe në këtë rregullore.
2. Kandidatët për drejtues të njësisë bazë në UNIKO, janë personel akademik me kohë të plotë të njësisë bazë që i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtarë të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore "Doktor".
3. Nuk mund të kandidojnë për drejtues të njësisë bazë në UNIKO, kandidatët që:
 - a) Kanë qenë drejtues të njësisë bazë të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme apo të ndara, në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, përlogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara me zgjedhje, pavaresisht kohëzgjatjes;
 - b) Kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*";
 - c) Kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese;
 - d) Janë në vit sabbatik në periudhën e kandidimeve.

Neni 23

Kriteret për anëtarët e Komisioneve të Përhershme në UNIKO

1. Kandidatët për anëtarë të komisioneve të përhershme në UNIKO, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe në ligjin nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*". Kandidatët për anëtarë të Komisioneve të Përhershme duhet të kenë integritet të lartë akademik, veç të tjerash edhe, në kuptimin e rregullshmërisë së zbatimit të procedurave të përfitimit të gradave dhe titujve akademikë.
2. Numri i komisioneve dhe vendeve për anëtarë të Komisioneve të Përhershme përcaktohen nga Senati Akademik në përputhje me përcaktimet e statutit të UNIKO-së, por jo më pak se 5 (pesë) anëtarë për secilin komision. Në përbërje të komisioneve të përhershme përfaqësohen edhe studentët, sipas përcaktimeve të Statutit të UNIKO-së, me përjashtim të Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" dhe Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në rast se institucionet e gëzojnë të drejtën për ngritjen e këtyre komisioneve.
3. Kandidatët për anëtarë të Komisioneve të Përhershme vijnë nga radhet e personelit akademik me kohë të plotë të UNIKO-së, sipas përcaktimeve të nenit 11 të kësaj rregulloreje.

Neni 24

Kandidimi

1. Kandidatët për autoritete drejtuese të të gjithë niveleve, për Senatin akademik dhe Komisionet e Përhershme, vetëkandidohen.
2. Kandidatët për Senatin Akademik, përfaqësues të studentëve, propozohen nga jo më pak se 30 studentë, pjesë e trupës zgjedhore, të cilët mbështesin vetëm një kandidat. Në fletën që dëshmon për mbështetjen nga 30 studentë, duhet të jenë pasqyruar emri, mbiemri, dokumenti i identifikimit, fakulteti/dega nga vjen studenti, si dhe nënshkrimi i tij.
3. Dokumentet e kandidimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", Statutit të UNIKO së dhe kërkesat e kësaj rregulloreje.

Neni 25

Përjashtimi nga kandidimi

Nuk mund të kandidojnë për autoritete (rektor, dekan, përgjegjës departamenti) dhe organe drejtuese (senati akademik dhe komisione të përhershme) të UNIKO-së, kandidatët që:

- a) Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal.
- b) Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- c) Janë të dënuar më parë për vepra penale.
- d) Ndaj tyre është dhënë më parë masë disiplinore.

- e) Nuk dorëzojnë formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ-it) për integritetin akademik, mbështetur në ligjin nr. 45/2016 *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*; në ligjin 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar; në ligjin nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*.

Neni 26

Dokumentacioni për kandidim

1. Dokumentacioni për kandidim nga kandidatët për rektor dhe anëtar të Senatit Akademik dorëzohet në KIZ, ndërsa dokumentacioni për kandidim nga kandidatët për drejtues të njësisë kryesore dhe drejtues të njësisë bazë dorëzohet në KZF. Ky dokumentacion duhet të përmbajë:
 - a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban: emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim; deklarin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, *“Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”* dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara me zgjedhje, pavarësisht kohëzgjatjes, si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkohet të kandidojë në të njëjtin institucion; deklarin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale; deklarin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”* dhe ligjit nr. 45/2015 *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*.
 - b) Kopje të dokumentit të identifikimit.
 - c) Kopje të noterizuar të titullit akademik.
 - d) Formularët e deklarimit të vënë në dispozicion nga KIZ/KZF.
 - e) Dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar.
2. Dokumentet e kandidimit për studentët dorëzohen në KIZ dhe përmbajnë:
 - a. Kërkesën për kandidim, e cila përfshin: emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim.
 - b. Kopje të dokumentit të identifikimit.
 - c. Vërtetimin që provon se është student me kohë të plotë në UNIKO.
 - d. Propozimin nga jo më pak se 30 studentë pjesë e trupës zgjedhore, sipas standardeve të parashikuara në këtë rregullore, të cilët, krahas emrit, mbiemrit dhe nënshkrimit vendosin në shkresën e propozimit edhe numrin personal të kartës së identitetit.
 - e. Dokumentin që vërteton mesataren e notës mbi bazën e provimeve të dhëna deri në momentin e kandidimit.
3. Pas verifikimit të dokumentacionit KIZ-i, jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listën e kandidatëve për rektor dhe të kandidatëve për Senatit Akademik. Listat shpallen publikisht në mjediset e të gjithë njësisve kryesore të UNIKO-së.
4. Pas verifikimit të dokumentacionit, KZF-ja, jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listën e kandidatëve për dekan, si dhe listën e kandidatëve për drejtues të njësisë bazë, për secilën prej njësisve bazë të njësisë kryesore.

5. Pas regjistrimit, çdo kandidati i jepet vërtetimi i regjistrimit (tip) si kandidat prej komisionit zgjedhor që kryen regjistrimin e tij. Forma e këtij vërtetimi miratohet me vendim të KIZ-it.

Neni 27
Kohëzgjatja e mandateve

1. Organet dhe autoritetet drejtuese të UNIKO-së zgjidhen për një mandat 4-vjeçar, ndërsa komisionet e përhershme zgjidhen për një mandat 2-vjeçar. Rastet e ndërprerjes së mandateve përcaktohen në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
2. Mandati i anëtarëve të KIZ-it/KZF-së dhe Komisionit të Apelit është 4- vjeçar.

Neni 28
Përfaqësimi i njësive kryesore në Senatin Akademik

Jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve, Senati Akademik i UNIKO-së, me vendim, shpall numrin e përfaqësuesve në Senatin Akademik të ardhshëm, sipas përcaktimeve të bëra në Statutin e UNIKO-së.

Neni 29
Fushata Zgjedhore në UNIKO

1. Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve të shpallur nga ministri përkatës.
2. Fushata zgjedhore përfundon 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Dita para datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve deri në mbylljen e votimit, formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore.
3. Administratori dhe administrata e UNIKO-së duhet t'u krijojë kushte të përshtatshme dhe të barabarta të gjithë kandidatëve për të zhvilluar aktivitetet e tyre në kuadër të fushatës elektorale. Në përputhje me kërkesën e kandidatit për kohën dhe vendin për zhvillimin e aktivitetit, administrata e institucionit merr të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e tij, jashtë orëve të mësimit që zhvillohen në institucion.
4. Administratori dhe administrata e UNIKO-së në asnjë rast nuk duhet të përfshihen në procesin zgjedhor në favor të ndonjë kandidati.

KREU V

PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS DHE E DOKUMENTACIONIT PËR ZGJEDHJET

Neni 30

Vendndodhja e komisioneve zgjedhore dhe e vendeve të numërimit të votave

1. Vendndodhja e komisioneve zgjedhore përcaktohet sipas rregullit të mëposhtëm:
 - a) Selia e KIZ-it vendoset në godinën ku ndodhet administrata qendrore e UNIKO-së.
 - b) Selia e KZF-së vendoset në godinën ku zhvillon aktivitetin mësimor njësia kryesore.
2. Vendet e numërimit të votave përcaktohen sipas rregullit të mëposhtëm:
 - a) Votat për rektor, drejtuesin e njësisë kryesore, drejtuesin e njësië bazë, për anëtar të Senatit Akademik dhe anëtar të Komisioneve të Përhershme, numërohen në një sallë në godinën ku zhvillon aktivitetin mësimor njësia kryesore.
 - b) Vendet e numërimit të votave duhet të jenë salla me përmasa të mëdha, të cilat të krijojnë mundësinë për zhvillimin normal të procesit të numërimit të votave. Organizimi i sallës për numërimin e votave duhet t'iu japë mundësi kandidatëve dhe vëzhguesve të tyre për të qenë të pranishëm, gjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave.

Neni 31

Komisionet për vlerësimin dhe numërimin e votave

1. Votat për rektor, anëtar të Senatit Akademik, drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë dhe për anëtarë të Komisioneve të Përhershme, vlerësohen dhe numërohen prej KZF-së.
2. KZF-ja, pas numërimit të votave, plotëson tabelat zgjedhore për secilën kategori dhe ia përcjell KIZ-it.
3. KIZ-i, pas kalimit të afateve për ankimin, shpall fituesit sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

Neni 32

Përgatitja e dokumentacionit zgjedhor

1. Për zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik të UNIKO-së, personeli akademik voton me pesë fletë me ngjyra të ndryshme:
 - a) Fletëvotimi për rektor;
 - b) Fletëvotimi për drejtues të njësisë kryesore;
 - c) Fletëvotimi për drejtues të njësisë bazë;
 - d) Fletëvotimi për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik;
 - e) Fletëvotimi për Komisionet e Përhershme nga personeli akademik.
2. Për zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik studentët votojnë me katër fletë votimi me ngjyra të ndryshme:
 - a) Fletëvotimi për rektor;
 - b) Fletëvotimi për drejtues të njësisë kryesore;
 - c) Fletëvotimi për anëtarë të Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve.
 - d) Fletëvotimi për anëtarë të Komisioneve të Përhershme, përfaqësues i studentëve.

3. Sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve sipas listës përfundimtare, duke i shtuar 2 % (dy për qind).
4. Fleta e votimit përgatitet prej KIZ-it. Duhet të jetë prej letre, me ngjyrë dhe trashësi që të mos lejojë leximin e votës në pjesën e pasme të saj. Fletët e votimit prodhohen në blloqe pa kundërfletë me numra serial unik. Informacioni që përmban fleta e votimit është:
 - a) Në krye të fletës së votimit vendoset emërtesa për të cilin do të përdoret.
 - b) Emërtimi i autoritetit drejtues, Senati Akademik ose Komisioni i Përhershëm.
 - c) Emri, atësia, mbiemri për kandidatët e regjistruar për autoritetin ose organin drejtues përkatës, të cilët renditen sipas rendit alfabetik.
 - d) Në rastin kur për autoritetin drejtues ose anëtar të Senatit Akademik është regjistruar dhe konkurren vetëm një kandidat, dhe kur për anëtar të Senatit Akademik konkurrojnë më pak ose po aq kandidatë sa numri i mandateve, në fletën e votimit krahas emrit të tij vendosen alterantivat për votim "Pro" ose "Kundër"
 - e) Fleta e votimit për studentët në sfond të saj ka të shkruar "Për student".

Neni 33

Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KIZ në KZF

1. Një ditë përpara datës së zgjedhjeve, KIZ-i dërgon në KZF materialet zgjedhore, si më poshtë:
 - a) Fletët e votimit për personelin akademik dhe për studentët, në përputhje me numrin e votuesve në njësinë kryesore të UNIKO-së;
 - b) Listën përfundimtare të zgjedhësve për personelin akademik dhe listën e zgjedhësve për studentët;
 - c) Vulën e KZF-së;
 - d) Vulën e KQV-së, në rast se në njësinë kryesore do të ketë më shumë se një qendërvotimi.
 - e) Procesverbalet e qendrës së votimit, ku bëjnë pjesë: procesverbalet për vulosjen e kutive të votimit, hapjen e qendrës së votimit, pezullimin e votimit, si dhe mbylljen e votimit;
 - f) Zarfën në të cilin është shënuar "Fletëvotimi të dëmtuara";
 - g) Zarfën në të cilin është shënuar "Fletëvotimi të papërdorura";
 - h) Zarfën në të cilin është shënuar "Zarfi i procesverbalit të vulosjes";
 - i) Zarfën në të cilin është shënuar "Zarfi i fletëve të votimit të hedhura në kutinë e gabuar".
2. Përveç kutisë me materiale zgjedhore në KZF, dërgohen edhe kutitë e votimit:
 - a) Kutia e votimit për rektor;
 - b) Kutia e votimit për dekan të njësive kryesore;
 - c) Kutia e votimit për përgjegjës të njësive bazë;
 - d) Kutia e votimit për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik i njësive kryesore;
 - e) Kutia e votimit për anëtar të Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve;
 - f) Kutitë e votimit për Komisionet e Përhershme;
 - g) Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZF-së;
 - h) Tabelat për rezultatin e zgjedhjeve për secilën kategori;
 - i) Dhomat e fshehta;

j) Vulat me kodet e sigurisë.

KREU VI

VOTIMI

Neni 34

Veprimet paraprake për hapjen e Qendrës së Votimit

1. KZF, nën drejtimin e kryetarit dhe sekretarit dhe në prani të vëzhguesve, një orë përpara hapjes së Qendrës së Votimit, kryen këto detyra:
 - a) Vendosttryezat, karriget, dhomën e fshehtë dhe kutitë e votimit në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit, lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve;
 - b) Afishon udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm, brenda Qendrës së Votimit;
 - c) Afishon tabelat që ndalojnë përdorimin e çdo objekti që çënon fshehtësinë e votës;
 - d) Kontrollon të gjitha materialet e marra në dorëzim;
 - e) U tregon vëzhguesve kutitë e votimit të zbrazëta. Në faqen e përparme të çdo kutie votimi vendoset emërtimi për autoritetin që do të votohet me ngjyrë të njëjtë me atë të fletës përkatëse të votimit;
 - f) Mbyll kutitë e votimit me kodet e sigurisë dhe i shkruan këto kode në procesverbalin e vulosjes së kutive të votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KQV-së. Procesverbali mbyllet në zarfin ku është shkruar "Zarfi i procesverbalit të vulosjes", i cili futet në kutinë e votimit për rektor para fillimit të procesit të votimit;
 - g) Sigurohet që në ambientet zgjedhore të mos ketë persona dhe shenja që çënojnë parimin e paanshmërisë dhe drejtësisë në procesin zgjedhor.
2. Anëtarët e KZF-së, në prani të kandidatëve dhe vëzhguesve të akredituar nga KIZ-i, në rast se paraqiten, marrin vendim për hapjen e votimit dhe e nënshkruajnë atë.
3. Të njëjtat veprime kryen edhe nga KQV-ja në rastin kur në njësinë kryesore votimi kryhet në më shumë se një qendër votimi.

Neni 35

Procedurat e votimit

1. Votimet për autoritetet drejtuese të të gjitha niveleve dhe Senatit Akademik në UNIKO zhvillohen në një ditë të vetme, në datën e caktuar nga ministri përgjegjës për arsimin.
2. Pas kryerjes së detyrave të përcaktuara në këtë rregullore, kryetari i KZF-së/KQV-së deklaron hapjen e votimit, jo më përpara se ora 08.00.
3. Sekretari shënon në Librin e Protokollit të KZF-së/KQV-së kohën e largimit të përkohshëm dhe të kthimit të çdo anëtari të komisionit prej Qendrës së Votimit. Kur kryetari largohet nga qendra e votimit, ai ia kalon vulën e kryetarit, për përdorim, një anëtari të komisionit.
4. Fletët e votimit vulosen në pjesën e pasme, në vendin e caktuar me vulën e KZF-së e cila mban

respektivisht shkrimin "KZF" dhe emrin e Njesisë kryesore dhe Njesisë Bazë.

5. Në qendrën e votimit vendosen kuti votimi në numër të barabartë me numrin e autoriteteve drejtuese, rektor, dekan, përgjegjës departamenti dhe komisione të përherëshme për të cilat kryhet votimi në njësinë kryesore të UNIKO-së dhe dy kuti për Senatin Akademik, një për anëtarët e senatit nga personeli akademik dhe një për anëtarët e senatit përfaqësues të studentëve si dhe kutitë përkatëse për rektor dhe drejtues të njësisë kryesore ku votojnë studentët.
6. Në mjediset e njësive kryesore, ku kryhet procesi i votimit ndalohet rreptësishtë çdo lloj forme fushate zgjedhore për kandidatët konkurrentë.
7. Zgjedhësit qëndrojnë në radhë jashtë Qendrës së Votimit dhe futen njëri pas tjetrit në Qendrën e Votimit për të votuar, me thirrjen e një anëtari të komisionit. Pasi hyn në Qendrën e Votimit:
 - a) Zgjedhësi thotë emrin e tij, nëse është personel akademik apo student, njësinë bazë ku bën pjesë dhe paraqet para komisionit një nga dokumentet zyrtare të vlefshme për identifikim:
 - i. Letërnjoftim
 - ii. Pasaportë.
 - b) Kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën përfundimtare të zgjedhësve, dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë së dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë;
 - c) Zgjedhësi që është pajisur nga KIZ-i me vendim për të votuar, pasi hyn në qendër e paraqet atë të kryetari i qendrës. Emri i këtij zgjedhësi dhe numri i kartës së identitetit të tij shënohet në një regjistër të veçantë;
 - d) Zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij;
 - e) Zgjedhësit, personel i stafit akademik, i jepen për të votuar fletët e votimit për rektor, drejtues të njësisë kryesore, për përgjegjës departamenti në të cilën bëjnë pjesë dhe për fletën e votimit për anëtarë të personelit akademik në Senatin Akademik;
 - f) Zgjedhësit, student, i jepen për të votuar fletët e votimit për rektor, për drejtues të njësisë kryesore dhe për anëtarë në Senatin Akademik përfaqësues i studentëve;
 - g) Çdo fletë e votimit vulloset në pjesën e pasme të saj, me vulën e KZF-së/KQV-së.
 - h) Pasi merr fletët e votimit zgjedhësi hyn në dhomën e fshehtë dhe:
 - i. në fletën e votimit për rektor, për drejtues të njësisë kryesore dhe për drejtues të njësisë bazë, shënon në krah të emrit të kandidatit shkruan shenjën "x"/"+"/"√" që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Shenja duhet të vendoset vetëm në krah të një emri. Në rastin kur për autoritet drejtues konkurron vetëm një kandidat zgjedhësi voton një nga alternativat e shkruara krahas emrit të kandidatit "Pro" ose "Kundër";
 - ii. Në fletën e votimit për anëtar të Senatit Akademik shënon, në krah të emrave të kandidatëve shenjën "x"/""/"√" që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Zgjedhësi duhet të shënojë jo më shumë çanta sesa është numri i mandateve në Senatin Akademik që i përketin njësisë kryesore përkatëse;
 - iii. Pasi bën shënimin në fletën e votimit, i palos fletët në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, del nga dhoma e fshehtë, i hedh fletët në kutitë përkatëse të votimit dhe largohet nga Qendra e Votimit;
 - i) Nëse shënuimi në fletën e votimit apo në të paktën një nga fletët e votimit bëhet jashtë dhomës

së fshehtë, zgjedhësi nuk lejohet të fusë fletën/fletët e votimit në kuti. Kryetari i qendrës e merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët "E dëmtuar" dhe e fut atë në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara". Në këtë rast, zgjedhësit i jepet një fletëvotimi tjetër, e të njëjtit lloj, dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin "Fletëvotimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletëvotimi. Nëse zgjedhësi bën shënim ose e dëmton fletën e votimit pa dashje dhe kërkon një fletëvotimi të dytë, fleta e votimit konsiderohet "e dëmtuar" dhe futet në zarfin "Fletëvotimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit i jepet një fletëvotimi e dytë. Rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon ose dëmton përsëri pa dashje fletën e dytë të votimit, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin "Fletëvotimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletëvotimi. Në asnjë rast fletët e votimit të dëmtuara nuk hidhen në kutitë e votimit.

- j) Qendra e votimit organizohet në një mënyrë të tillë që të lehtësojë procesin e votimit dhe të garantojë plotësisht fshehtësinë e votës. Në qendrën e votimit është e ndaluar përdorimi i mjeteve të komunikimit apo regjistrimit nga ana e votuesit. Në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm:
- i. anëtarët dhe sekretari i *KZF-së/KQV-së*;
 - ii. zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit deri në përfundim të tyre;
 - iii. vëzhguesit e akredituar;
 - iv. përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Neni 36 **Mbyllja e votimit**

1. Qendrat e votimit mbyllen në orën e caktuar. Nëse edhe pas kalimit të këtij orari ka zgjedhës që presin në radhë, komisioni mbledh dokumentet e identifikimit të të gjithë zgjedhësve të pranishëm dhe i thërret ata me radhë për të kryer votimin. Asnjë zgjedhës tjetër nuk do të lejohet të votojë, nëse nuk ka qenë në radhë në kohën e mbledhjes së dokumentit të identifikimit.
2. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm, komisioni merr vendim për mbylljen e votimit, duke plotësuar formularin përkatës, ku shënohet edhe ora e mbylljes së votimit. Pas kësaj, në Qendrën e Votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët dhe sekretari i *KZF-së/KQV-së*, si dhe vëzhguesit e akredituar, kandidatët dhe përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Neni 37 **Veprimet pas mbylljes së Qendrës së Votimit**

Pas marrjes së vendimit për mbylljen e votimit, kryetari së bashku me anëtarët e *KZF-së/KQV-së* kryejnë, sipas radhës, veprimet e mëposhtme:

1. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve:
 - a) shënon numrin e zgjedhësve që kanë votuar nga personeli i stafit akademik dhe studentët, duke numëruar nënshtiktimet e bëta në listën përkatëse të zgjedhësve, si dhe atyre që janë në regjistrim

- e veçantë, që kanë votuar sipas kushteve të parashikuara në këtë rregullore;
- b) ia deklaron shifrat me zë të lartë anëtarëve të tjerë të Komisionit dhe vëzhguesve të pranishëm;
- c) i fton ata të verifikojnë shifrat e thëna prej tij;
- d) urdhëron sekretarin e komisionit të shënojë në procesverbalin për "Mbylljen e votimit" numrin e personave që kanë votuar në qendrën e votimit. Në rast kundërshtimesh për përcaktimin e shifrës, pretendimet shënohen në procesverbal.
2. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve, pasqyron në procesverbalin për "Mbylljen e votimit" numrin e plotë të fletëve të votimit të qendrës së votimit, për secilin prej kategorive, duke u bazuar tek të dhënat që kanë shoqëruar marrjen në dorëzim të fletëve të votimit nga KIZ-i, numrin e fletëve të papërdorura dhe numrin e fletëve të dëmtuara për secilën kategori.
3. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, fillon numërimin e fletëve të votimit të papërdorura për secilin prej kategorive dhe, në përfundim të numërimit ia bën të ditur shifrat anëtarëve të komisionit. Nëse kërkohet nga një anëtar i komisionit ose ndonjë nga vëzhguesit, kryetari është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit të papërdorura. Në përfundim të numërimit, fletët e votimit të papërdorura mbyllën në zarfin ku është shënuar "Fletëvotimi të papërdorura" për secilën kategori. Numri i fletëve të votimit të papërdorura pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit"
4. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, numëron fletët e votimit të dëmtuara që gjenden në zarfin "Fletëvotimi të dëmtuara" për secilën kategori. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit".
5. Në përfundim të veprimeve të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni, futen:
- a) Në kutinë e materialeve zgjedhore për zgjedhjen e rektorit:
- i. zarfi "Fletëvotimi të papërdorura për zgjedhjen e rektorit";
 - ii. zarfi "Fletëvotimi të dëmtuara për zgjedhjen e rektorit";
 - iii. procesverbali për numrin e fletëve të votimit gjithsej, numrin e fletëve të papërdorura dhe numrin e fletëve të dëmtuara.
- b) Për secilën kategori veprohet në të njëjtën mënyrë.
6. Mbyllet kutia e votimit. Elementët e sigurisë për mbylljen e këtyre kutive shënohen në procesverbal.
7. Kutia e votimit dhe kutia e materialeve zgjedhore përkatëse dërgohet në KIZ. Kutitë shoqërohen nga dy anëtarë të KZF-së dhe mund të shoqërohen nga vëzhguesit e kandidatëve dhe përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
8. Në rastin kur në njësinë kryesore votimi është kryer në më shumë se një qendër votimi, komisioni i qendrës së votimit pas administrimit të materialeve zgjedhore, sipas rregullave të përcaktuara në këtë nen, i dorëzon ato së bashku me kutinë e votimit për rektor në KZF, e cila është përgjegjëse për transportin e tyre në KIZ.

Neni 38

Procedurat e vlerësimit të fletëve të votimit

1. Procedurat për vlerësimin, numërimin dhe nxjerrjen e rezultatit për zgjedhjen e rektorit, autoritetit drejtues në njësitë kryesore, autoritetit drejtues në njësitë bazë, për anëtar në Senatit Akademik dhe për anëtarë në Komisionet e perhershme kryhen prej KZF-së në një sallë të caktuar

- prej saj dhe që ndodhet në mjediset e njësisë kryesore.
2. Në rastin kur procesi i votimit është kryer në më shumë se një qendër votimi në njësinë kryesore, Komisioni i qendrës së votimit, pasi ka përfunduar administrimin e materialeve zgjedhore sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, i dorëzon ato në sallën e numërimit të votave, KZF-së. Dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe i kutive të votimit bëhet me procesverbal.
 3. Vlerësimi, numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultateve zhvillohet sipas radhës së mëposhtme:
 - a) Rektor;
 - b) Drejtues i njësisë kryesore;
 - c) Drejtuesi i njësisë bazë;
 - d) Anëtarë të Senatit Akademik (personel akademik dhe studentë)
 - e) Anëtarë të Komisioneve të përhershme (personel akademik dhe studentë).
 4. Kryetari hap kutinë e votave për rektor, nxjerr nga kutia fletët e votimit, i shpalos dhe i vendos mbi tryezë, me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme. Pas kësaj:
 - a) Vlerëson të gjitha votat e gjetura në kuti, duke ia treguar të gjithë anëtarëve të komisionit dhe vëzhguesve. Votat e pavlefshme ndahen në një grup të veçantë.
 - b) Numëron votat e vlefshme dhe votat e pavlefshme. Numri i tyre, së bashku me numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti, shënohen në procesverbal.
 - c) Verifikon numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti me numrin e votave që duhet të ishin në kuti në bazë të të dhënave të procesverbalit të KZF-së/KQV-së, për numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit, fletët e votimit të papërdorura dhe fletët e votimit të dëmtuara. Rezultati shënohet në procesverbal.
 - d) Ndan në grupe të veçanta votat e hedhura nga personeli akademik dhe nga studentët dhe i numëron votat e secilit grup. Numri i tyre shënohet në procesverbal.
 - e) Ndan votat e personelit akademik në grupe sipas emrit të kandidatit dhe i numëron. Votat e gjetura shënohen në procesverbal.
 - f) Ndan votat e studentëve në grupe sipas emrit të kandidatit dhe i numëron. Votat e gjetura shënohen në procesverbal.
 - g) Harton tabelën përfundimtare për votimin në njësinë kryesore përkatëse dhe e miraton me vendim.
 5. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:
 - a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KIZ-i;
 - b) fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në këtë rregullore;
 - c) në fletën e votimit janë bërë shënime të tjera përveç atyre të lejuara apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;
 - d) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;
 - e) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
 - f) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
 - g) nuk është e qartë se për kë është votuar ose zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit;

- h) Kur fleta e votimit është hedhur në kutinë e gabuar.
6. Në rast se në njësinë kryesore është votuar në më shumë se një qendër votimi, KZF-ja vlerëson dhe numëron votat për secilën qendër votimi sipas procedurës së përshkruar më sipër.
 7. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave për rektor, KZF-ja harton tabelën e rezultatit të votave për rektor të cilën e përcjell në KIZ. Kopje e tabelës të rezultatit të votave për rektor u jepet, sipas kërkesës, vëzhguesve, kandidatëve dhe përfaqësuesve të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
 8. Në rastin kur nuk ka asnjë fitues për rektor, për një apo më shumë autoritete drejtuese të njësive kryesore apo njësive bazë, KIZ-i, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje, merr vendim për organizimin dhe zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve.
 9. KZF-ja vazhdon procesin e vlerësimit dhe numërimit të votave për drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë, për anëtarët e Senatit Akademik dhe Komisioneve të përhershme duke ndjekur, për aq sa është e nevojshme, procedurën e përshkruar në këtë nen.
 10. Anëtarët e KZF-së, në rast mos dakordësie, gjatë numërimit të votave, referuar rasteve të fletëvotimeve të diskutueshme, marrin vendimin mbi to me shumicë të thjeshtë votash. Kjo zgjidhje e përjashton kategorikisht bllokimin e procesit.
 11. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave, KZF-ja harton tabelën përfundimtare të rezultateve të votimit dhe shpall me vendim të veçantë rezultatet për secilën kategori. Tabela përfundimtare dhe vendimi i KZF-së, nënshkruhen nga të gjithë anëtarët duke deklaruar votën "Pro" apo "Kundër" dhe vulosen nga sekretari. Kopje të tabelës përfundimtare të rezultatit të zgjedhjeve u jepet, sipas kërkesës, vëzhguesve të kandidatëve. Rezultatet e votimit për Senatit Akademik përcillen në KIZ.
 12. Mënyra e përlogaritjes së votave për autoritetet drejtuese për të cilët votojnë dhe studentë, do të jetë:

$$R\% = \frac{A}{N1} * 90\% + \frac{B}{N2} * 10\%$$

R% - është rezultati i shprehur në përqindje i një kandidati për një pozicion të caktuar; A

- është numri i votave pro kandidatit nga personeli akademik;

N1 - është numri i përgjithshëm i votave të vlefshme nga personeli akademik;

B - është numri i votave pro kandidatit nga studentet;

N2 - është numri i përgjithshëm i votave të vlefshme nga studentët.

13. Vendimet e KZF-së për tabelat e rezultateve të zgjedhjeve ankimohen në KIZ.
14. Gjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave në vendin e numërimit të votave kanë të drejtë të qëndrojnë anëtarët dhe sekretari i KZF-së, kandidatët dhe vëzhguesit e tyre të akredituar dhe përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
15. Çdo kontestim i kandidatëve apo vëzhguesve të tyre, shënohet detyrimisht në librin e procesverbaleve nga sekretari i KZF-së.

Neni 39

Ankimimet

1. Çdo kandidat pjesëmarrës në zgjedhjet për autoritetet drejtuese ose anëtar në Senatit Akademik të

UNIKO-së, ka të drejtë të ankohet në KIZ kundër vendimeve të KZF-së që cenojnë interesat e tij, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike, nga data e shpalljes së vendimit.

2. Kundër vendimeve të KZF së për shpalljen e tabelave të rezultatit, tabelave përmbledhëse të rezultatit dhe rezultatit të zgjedhjeve, ankimi bëhet në KIZ, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike, nga data e shpalljes së tyre.
3. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha dy ditore fillon në orën 16.00 të ditës së shpalljes së aktit për të cilin bëhet ankimi dhe përfundon në orën 16.00, pas dy ditëve kalendarike.
4. KIZ-i administron dhe merr vendim për ankimet për çështje që nuk lidhen me rezultatin e zgjedhjeve, jo më vonë se 24 orë pas paraqitjes së tyre.
5. KIZ-i administron dhe merr vendime për ankimet për rezultatin e zgjedhjeve jo më vonë se 48 orë pas paraqitjes së tyre.
6. Çdo vendim i KIZ-it është i ankimeshem në Komisionin e Apelit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e shpalljes së vendimit. Komisioni Apelit shprehet me vendim të arsyetuar brenda 10 ditëve kalendarike.

Neni 40

Ankimi në Komisionin e Apelit

1. Komisioni i Apelit përbëhet nga 5 anëtarë (një përfaqësues për çdo fakultet dhe një përfaqësues nga studentët). Anëtarët përzgjidhen me short nga Senati Akademik i UNIKO-së, jo më vonë se një ditë pas përfundimit të afatit të aplikimit.
2. Për formimin e tij, Senati Akademik i UNIKO-së jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve, publikon kërkesën për aplikim për anëtar në Komisionin e Apelit të institucionit. Të drejtën për të aplikuar e kanë individët që:
 - a) Kanë përvojë pune në mësimdhënie, jo më pak se 5 (pesë) vjet, me kohë të plotë;
 - b) Përfaqësuesi i studentëve të jetë nga programet e ciklit të dytë të studimeve;
 - c) Nuk kanë qenë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
 - d) Nuk kanë lidhje gjinore në vijë të drejtë ose të tërthortë, deri në shkallë të katërt, me kandidatë që konkurrojnë në zgjedhje. Në rast konstatimi të tillë, anëtari dorëhiqet menjëherë dhe zëvendësohet nga Senati Akademik me short.
3. Komisioni i zgjedhur i Apelit, në mbledhjen e parë zgjedh Kryetarin dhe Sekretarin e tij, me shumicën e thjeshtë të votave. Komisioni i Apelit i ushtron funksionet e tij për një mandat 4-vjeçar.
4. Rregullat për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Apelit hartohen dhe vendosen prej këtij komisioni, menjëherë pas konstituimit të tij dhe zgjedhjes të kryetarit dhe sekretarit.
5. Komisioni i Apelit shqyrton dhe merr vendim të arsyetuar, në të cilin përfshihen dhe mendimet "kundër", për çdo ankim për vendime të marra prej KIZ-it.
6. Vendimi i Komisionit të Apelit është i formës së prerë, përfundimtar, i detyrueshëm për t'u zbatuar.
7. Kundër vendimeve të Komisionit të Apelit, bëhet ankim në rrugë gjyqësore nga pala që ka interes të ligjshëm.

Neni 41
Pavlefshmëria e Zgjedhjeve

1. KIZ-i, kryesisht ose me kërkesë të kandidatëve, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një ose më shumë njësi kryesore, në rast se:
 - a) Kanë ndodhur shkelje të ligjit dhe të kësaj rregulloreje që kanë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në fitimin e mandateve;
 - b) Kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim;
 - c) Votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se 5 (pesë) orë.
2. Kërkesën për pavlefshmëri të zgjedhjeve kërkesi duhet ta shoqërojë me shpjegimin për shkaqet ligjore ku mbështetet kërkesa, përshkrimin e shkeljeve të pretenduara dhe arsyetimin e detajuar të tyre për pasojat që kanë prodhuar.
3. Shqyrtimi i kërkesës për pavlefshmëri të zgjedhjeve dhe vendimarrja për kërkesën, bëhet nga KIZ-i, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga depozitimi i saj.
4. Pas vendimit për pavlefshmëri të zgjedhjeve, shpallen zgjedhje të reja sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015 *“Per arsimin e larte dhe kerkamin shkencor ne institucionet e arsimit te larte ne Republikën e Shqipërisë”* dhe kësaj rregulloreje.

Neni 42
Dispozita të fundit

1. Në rastet e mosmiratimit të Komisioneve të Përhershme, për këto organe nuk zhvillohen zgjedhje, deri në miratimin e tyre, sipas kuadrit ligjor në fuqi.
2. Anëtarët e të gjitha komisioneve të ngritura sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, shpërblehen për punën që bëjnë. Masa dhe mënyra e shpërblimit të tyre caktohet me vendim të Bordit të Administrimit, sipas propozimeve të bëra nga Senati Akademik i UNIKO-së.
3. Me perfundimin e procesit të shqyrtimit të ankimimeve në Komisionin e Apelit, KIZ-i shpall rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve dhe fituesit për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të UNIKO-së, si dhe kategoritë e tjera sipas përcaktimeve të kësaj rregullore.
4. KIZ-i i përcjell ministrit përgjegjës për arsimin vendimin për shpalljen e fituesit rektor të UNIKO-së. Ministri përgjegjës për arsimin pas verifikimit të ligjshmërisë së procesit zgjedhor, i përcjell Presidentit të Republikës vendimin e KIZ-it për shpalljen e fituesit rektor të UNIKO-së.
5. KIZ-i i përcjell rektorit brenda 2 (dy) ditëve nga dekretimi i tij vendimet për shpalljen e fituesve për anëtarët e Senatit Akademik dhe autoritetet drejtuese të njësive kryesore të UNIKO-së.
6. Rektori i zgjedhur dhe i dekretuar, emëron drejtuesit e zgjedhur të njësive kryesore të UNIKO-së, brenda muajit të parë të dekretimit të tij.
7. Dekani i zgjedhur i njësisë kryesore emëron drejtuesit e zgjedhur të njësive bazë brenda muajit të parë të emërimit të tij, pas marrjes së vendimit nga KIZ-i për shpalljen e fituesve për autoritetet drejtuese të njësive bazë.
8. Mbledhja e parë e Senatit Akademik të UNIKO-së mbahet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dekretimi i rektorit prej Presidentit të Republikës.

9. I gjithë dokumentacioni zgjedhor ruhet në arkivën e UNIKO-së, në bazë të rregullave të përcaktuara në kuadrin ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.
10. Monitorimi i procesit zgjedhor në të gjithë komisionet zgjedhore apo qendrat e votimit, realizohet nga vëzhguesit e akredituar të kandidatëve, kandidatët dhe përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
11. Kjo rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar si e tillë në Universitetin "Fan S. Noli" të Korçës.
12. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të saj nga Senati Akademik i UNIKO-së.
13. Rregullorja për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UNIKO, miratuar me vendimin nr. 78, datë 04.02.2020 të Seanatit Akademik të UNIKO-së, shfuqizohet.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI
Prof.dr. Dhimitri Bello

